



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 05/L -003**

**PËR MBIKËQYRJEN ELEKTRONIKE TË PERSONAVE, TË CILËVE  
U KUFIZOHET LËVIZJA ME VENDIM TË GJYKATËS**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR MBIKËQYRJEN ELEKTRONIKE TË PERSONAVE, TË  
CILËVE U KUFIZOHET LËVIZJA ME VENDIM TË GJYKATËS**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është të rregulloj përdorimin e mbikëqyrjes elektronike në procesin e drejtësisë penale për të ngritur sigurinë publike dhe për të garantuar ekzekutim efektiv të vendimeve të gjykatës, duke i respektuar plotësisht të drejtat e personave të përfshirë.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

1. Ky ligj zbatohet për mbikëqyrjen elektronike të personave, ndaj të cilëve me vendim të gjykatës janë vendosur:

1.1. masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit, të parashikuar nga nenet 176, 177, 178 dhe 183 të Kodit të Procedurës Penale;

1.2. urdhrat mbrojtës ose të mbrojtjes emergjente, të parashikuar me nenin 5 të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

### **Neni 3 Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **mbikëqyrje elektronike**- nënkupton mekanizmin që garanton zbatimin efektiv të vendimit të gjykatave, nëpërmjet përcaktimit në kohë reale të vendndodhjes së një personi, me anë të përdorimit të mjeteve elektronike të vendosura në trupin e tij;

1.2. **pajisje** – nënkupton mjetin elektronik i vendosur në trupin e personit dhe që mundëson përcaktimin në kohë reale të vendndodhjes së tij;

1.3. **person i afërt** –nënkupton personin që ka lidhje të afërta familjare në vijë të drejtë pa kufij ndërsa në vijë të tërthortë deri në shkallë të tretë me personin si dhe jeton në të njëjtën shtëpi me të;

1.4. **sallë operative**- nënkupton zyrën e cila funksionon në kuadër të Policisë së Kosovës, e cila realizon Mbikëqyrjen Elektronike për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave që vijnë nga pajisja dhe që mundëson kontrollin e zbatimit efektiv të vendimit gjyqësor;

1.5. **person** nënkupton personin e vendosur nën Mbikëqyrje Elektronike sipas përcaktimeve të këtij ligji.

### **Neni 4 Parimet e Mbikëqyrjes Elektronike**

1. Veprimtaria e organit të Mbikëqyrjes Elektronike bazohet në parimet:

1.1. ligjshmërisë;

1.2. mbrojtjes së rendit dhe sigurisë publike;

1.3. garantimit të lirisë personale të të dëmtuarit nga vepra penale apo të viktimës;

1.4. respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;

1.5. mosdiskriminimit;

1.6. proporcionalitetit të Mbikëqyrjes Elektronike me rrethanat e rastit dhe personalitetin e personit;

1.7. objektivitetit dhe efektivitetit.

## **KREU II**

### **PËRDORIMI I MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE**

#### **Neni 5**

##### **Nisma për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike**

Gjykata, vendos për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike me kërkesën e prokurorit, personit, mbrojtësit të tij, prindërve ose kujdestarit të personit të mitur.

#### **Neni 6**

##### **Pëlqimi i personit**

1. Gjykata, përpara shpalljes së vendimit përfundimtar, apo të ndonjë vendimi për masat e sigurimit të pranisë së të pandehurit, pyet personin nëse jep pëlqimin për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike dhe i shpjegon atij të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i saj te përcaktuara me këtë ligj.

2. Përdorimi i Mbikëqyrjes Elektronike vendoset vetëm me pëlqimin e personit dhe pasi gjykata sigurohet se ai i kupton të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i Mbikëqyrjes Elektronike.

3. Pëlqimi i personit për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike jepet me shkrim ose nëpërmjet deklaramit në seancë gjyqësore. Në rastin kur personit është i mitur, pëlqimi duhet të jepet në të njëjtën formë edhe nga prindërit ose kujdestari i tij ligjor.

4. Nëse personi nuk jep pëlqimin, sipas paragrafit 2 të këtij neni, gjykata nuk mund të vendosë përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike.

5. Përrjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, gjykata mund të vendosë përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike, edhe pa pëlqimin e personit, në rastin e parashikuar në nenin 2 paragrafin 1, nënparagrafin 1.2 të këtij ligji, nëse vlerëson se është e domosdoshme për të garantuar të drejtat kushtetuese të të tretëve dhe ekziston dyshimi i arsyeshëm, se personi paraqet rrezikshmëri për cenimin e këtyre të drejtave.

6. Kundër vendimit nga paragrafi 5 i këtij neni mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit

#### **Neni 7**

##### **Caktimi i personit të afërt**

Kur është e nevojshme dhe e mundur, personi cakton një person të afërt, i cili ndihmon në zbatimin e vendimit për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike. Nëse jep pëlqimin të caktohet si i tillë, personi i afërt ka detyrimin të vendosë në dispozicion të gjykatës, dhe organit që realizon Mbikëqyrje Elektronike, adresën e tij të saktë dhe numrin e telefonit për kontakt, që duhet të jenë të dispozicion në çdo kohë.

**Neni 8**  
**Vendimi për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike**

1. Përdorimi i Mbikëqyrjes Elektronike urdhërohet nga gjykata në vendimin gjyqësor të dhënë ndaj personit në rastet e përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji.
2. Gjkata, gjatë gjykimit para marrjes së vendimit, mund ti kërkojë Shërbimit Sprovues një raport parandëshkues për të pandehurin dhe nevojën e përdorimit të Mbikëqyrjes Elektronike.
3. Afati i kohëzgjatjes së Mbikëqyrjes Elektronike përcaktohet me vendim të gjykatës. Afati i kohëzgjatjes së mbikëqyrjes elektronike nuk mund të jetë më i gjatë se një (1) vit.

**Neni 9**  
**Përmbajtja e vendimit**

1. Vendimi gjyqësor që urdhëron përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike përveç si përcaktohet në Kodin e Procedurës Penale, përmban edhe:
  - 1.1. pëlqimin nga personi si përcaktohet me këtë ligj, apo pëlqimin nga prindi apo kujdestari i personit të mitur, për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike;
  - 1.2. zonat e lejuara dhe zonat e ndaluara të lëvizjes së personit;
  - 1.3. detyrimin e personit për të qëndruar brenda zonës së lejuar ose për të mos hyrë në zonën të ndaluara;
  - 1.4. kohëzgjatjen e përdorimit të Mbikëqyrjes Elektronike;
  - 1.5. njoftimin për personin se në rast të mosrespektimit të kushteve nga paragrafi 1 i këtij neni mund ti revokohet masa.

**KREU III**  
**REALIZIMI I MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE**

**Neni 10**  
**Organi që realizon Mbikëqyrjen Elektronike**

1. Policia e Kosovës realizon Mbikëqyrjen Elektronike dhe është përgjegjëse për vendosjen, heqjen dhe funksionimin e rregullt të pajisjes.
2. Vendi, koha dhe rregullat për vendosjen dhe heqjen e pajisjes përcaktohen në urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor, të cilët e njoftojnë menjëherë personin dhe organin që realizon Mbikëqyrjen Elektronike.

3. Organi që realizon Mbikëqyrjen Elektronike, nëpërmjet sallës operative mbledh, përpunon dhe raporton të dhënat që vijnë nga pajisja.

4. Kriteret që duhet të plotësojë organi që realizon Mbikëqyrjen Elektronike, të drejtat dhe detyrimet e tij caktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë.

### **Neni 11 Policia e Kosovës**

1. Policia e Kosovës, është organ përgjegjës për të kontrolluar mënyrën e realizimit të Mbikëqyrjes Elektronike.

2. Policia e Kosovës, i ofron gjykatës të dhëna të përditësuara për realizimin e Mbikëqyrjes Elektronike, sipas kërkesës së Gjykatës dhe Shërbimit Sprovues.

3. Realizimi i Mbikëqyrjes Elektronike dhe mënyra e raportimit nga ana e Policisë së Kosovës përcaktohet me akt nënligjor i nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

### **Neni 12 Pajisja për realizimin e Mbikëqyrjes Elektronike**

1. Mbikëqyrja Elektronike realizohet nëpërmjet vendosjes së një pajisje të posaçme në trupin e personit, e cila duhet:

1.1. të ketë përmasa të vogla, në mënyrë që të mbulohet lehtësisht nga veshjet dhe të mos shikohet nga të tretët;

1.2. të mos lëshojë tinguj ose dritë;

1.3. të përbëhet nga materiale të parrezikshme për jetën dhe shëndetin e personit dhe të personave të tretë;

1.4. të vendoset në një pjesë të trupit që e bën të pamundur shikimin e saj nga të tretët;

1.5. të lejojë personin të kryejë pa vështirësi të gjitha veprimtaritë e tij të zakonshme.

2. Pajisja duhet të plotësojë karakteristikat teknike si në vijim:

2.1. të jetë në gjendje të transmetojë sinjal nga çdo pjesë e territorit të Republikës së Kosovës;

2.2. të ketë rezistencë të lartë ndaj elementeve natyrore, e cila mundëson funksionimin normal edhe gjatë ekspozimit ndaj tyre;

2.3. të jetë e vështirë për t'u hequr;

2.4. të transmetojë sinjal të posaçëm nëse dëmtohet ose hiqet.

### **Neni 13**

#### **Salla operative**

1. Salla operative duhet të ketë kapacitet teknike të marrë në kohë reale informacionin për vendndodhjen e personave që ndodhen brenda territorit ku ushtron kompetencën organi që realizon Mbikëqyrjen Elektronike
2. Informacioni i siguruar nga pajisja i transmetohet drejtpërdrejt sallës operative, e cila funksionon pa ndërprerje.
3. Organi që realizon Mbikëqyrjen Elektronike siguron funksionimin pa ndërprerje të sallës operative dhe lidhjen e saj në kohë reale me pajisjen që përcakton vendndodhjen e personit.

### **Neni 14**

#### **Informacioni i transmetuar sallës operative**

1. Informacioni i siguruar nga pajisja shfaqet në harta, të cilat mundësojnë perceptimin e vendndodhjes së personit në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me sistemin rrugor dhe administrativ të Republikës së Kosovës.
2. Shfaqja e informacionit në harta dhe perceptimi pamor i tij është i ndaluar nëse personi qëndron brenda zonës së lejuar ose jashtë zonës së ndaluar të lëvizjes.
3. Informacioni për vendndodhjen e personit shfaqet në hartë vetëm në rast se:
  - 3.1. personi del nga zona e lejuar ose hyn në zonën e ndaluar të lëvizjes, sipas përcaktimit të vendimit gjyqësor që urdhëron përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike;
  - 3.2. personi dyshohet se ka shkelur kushtet e vendosura në vendimin gjyqësor;
  - 3.3. duhet të evitohet rreziku i mundshëm që i kanoset personit – ose personave të tjerë;
  - 3.4. personi mund të ketë dëmtuar ose hequr pajisjen;
  - 3.5. pajisja ka pësuar dëmtim aksidental dhe nuk transmeton informacionin përkatës.

### **Neni 15**

#### **Konfidencialiteti i informacionit**

1. Organi që realizon Mbikëqyrjen Elektronike, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, respekton rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Informacioni i siguruar për vendndodhjen e personit është i ndaluar t'u jepet personave tjerë, agjencive apo organeve që nuk janë të autorizuar me këtë ligj.

**KREU IV**  
**ZBATIMI I VENDIMIT PËR PËRDORIMIN E MBIKËQYRJES ELEKTRONIKE**

**Neni 16**  
**Detyrimet e personit**

1. Personi detyrohet të:

- 1.1. zbatojë kushtet e përcaktuara në vendimin gjyqësor;
- 1.2. vendosë në dispozicion të gjykatës dhe organit që realizon Mbikëqyrjen Elektronike adresën e saktë të banimit dhe të punës, si dhe numrin e telefonit i cili duhet të jetë në dispozicion në çdo kohë;
- 1.3. kthehet brenda zonës së lejuar të lëvizjes ose të largohet nga zona e ndaluar, brenda pesëmbëdhjetë (15) minutave nga çasti kur është kontaktuar nga salla operative;
- 1.4. mos dëmtoj ose heqë në asnjë rast pajisjen;
- 1.5. njoftojë menjëherë organin që realizon Mbikëqyrjen Elektronike për çdo dëmtim aksidental të pajisjes ose mosfunksionimin e saj.

**Neni 17**  
**Veprimet në rast të shkeljes së vendimit gjyqësor**

1. Kur informacioni në hartë evidenton daljen nga zona e lejuar ose hyrjen në zonën e ndaluar të lëvizjes, si edhe dëmtimin ose heqjen e pajisjes, salla operative kontakton menjëherë personin. Nëse ky i fundit nuk mund të kontaktohet, atëherë salla operative kontakton personin e afërt të përcaktuar në vendimin e gjykatës.
2. Nëse personi kthehet në zonën e lejuar ose largohet nga zona e ndaluar brenda pesëmbëdhjetë (15) minutave nga momenti që ai ose personi i afërt i tij kontaktohen nga salla operative, atëherë nuk ndërmerret asnjë veprim i mëtejshëm. Në këtë rast salla operative e evidenton këtë fakt në një regjistër të posaçëm.
3. Nëse personi dhe personi i afërt nuk mund të kontaktohen, salla operative njofton menjëherë Policinë, duke ia përcjell informacionin për vendndodhjen e personit. Salla operative, brenda njëzet e katër (24) orëve, njofton gjykatën dhe prokurorinë për shkeljen, dhe veprimet e kryera.
4. Informacionet e përcaktuara me këtë nen ruhen për një periudhë gjashtë (6) mujore, duke filluar nga çasti i evidentimit të shkeljes. Prokurori ose gjykata mund të urdhërojë që informacionet të ruhen për një kohë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.
5. Nuk evidentohet si shkelje e kushteve të përdorimit të Mbikëqyrjes Elektronike, rasti kur Gjykata apo Prokuroria i ka komunikuar me shkrim sallës operative autorizimin e lëshuar ndaj personit për të dalë nga zona e lejuar ose për të hyrë në zonën e ndaluar.

6. Autorizimi duhet të përmbajë përcaktimin e saktë të zonës ku lejohet të lëvizë subjekti dhe afatin e lejimit të lëvizjes.

7. Rregulla të hollësishme për kriteret e dhënies së autorizimeve përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë.

### **Neni 18**

#### **Shkelja e kushteve të Mbikëqyrjes Elektronike**

1. Policia e Kosovës vënë në dijeni gjykatën përkatëse, sapo të marrin njoftimin për shkeljen e kushteve të Mbikëqyrjes Elektronike.

2. Policia, kur vlerëson se janë shkelur qëllimisht, ose në mënyrë të përsëritur, kushtet për përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike, e harton raportin, të cilin ia paraqet gjykatës brenda dyzet e tetë (48) orëve.

3. Raporti detal i hartuar në rastet e parashikuara nga paragrafi 2 i këtij neni, i paraqitet të njëjtës gjykatë që ka vendosur përdorimin e Mbikëqyrjes Elektronike.

4. Gjykata, pasi vlerëson të gjitha rrethanat, vendos për vazhdimin apo ndërprerjen e Mbikëqyrjes Elektronike.



**KREU V**  
**DISPOZITA KALIMTARE**

**Neni 19**  
**Aktet nënligjore**

Ministria e Drejtësisë brenda gjashtë gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e tij.

**Neni 20**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa fillon të zbatohet nga 1 korriku i vitit 2015.

**Ligji Nr. 05/L -003**  
**7 maj 2015**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Kadri VESELI**